



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** Nr. KSC-CC-PR-2017-03

**Vendosi:** **Kryetarja e Dhomave të Specializuara**  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 28 qershor 2017

**Titulli:** Referim i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit

**Publik**

---

**Urdhër mbi riklasifikimin e Shtojcës I dhe Shtojcës II të Referimit të Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese**

---

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara, (“Kryetarja”), duke marrë parasysht “Referim i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese”<sup>1</sup> dhe “Aktvendim mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 29 maj 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”,<sup>2</sup> me anë të këtij vendimi riklasifikon Shtojcën I dhe Shtojcën II të Referimit të Rregullave të Rishikuara.

1. Më 29 maj 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare (“Plenarja”), me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, miratuan Rregullat e Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullat e Rishikuara”).

2. Më 31 maj 2017, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, Kryetarja i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”) Rregullat e Rishikuara për shqyrtim.<sup>3</sup> Një version përmbledhës i Rregullave të Rishikuara (Shtojca I), si edhe e gjithë Rregullorja (Shtojca II), iu bashkëngjitën Referimit të Rregullave të Rishikuara si shtojca me klasifikim konfidencial për të garantuar privatësinë e kuvendimeve të panelit të Gjykatës Kushtetuese. Njëkohësisht, Kryetarja përcaktoi se versioni publik i tyre “vihet në dispozicion pas vendimit të DHSGJK-së.”<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Referim i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarja, nr. KSC-CC-PR-2017-03, 31 maj 2017 (“Referimi i Rregullave të Rishikuara”).

<sup>2</sup> Aktvendim mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 29 maj 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nr. KSC-CC-PR-2017-03, 28 qershor 2017 (“Aktvendimi mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara”).

<sup>3</sup> Referimi i Rregullave të Rishikuara.

<sup>4</sup> Referimi i Rregullave të Rishikuara, para. 6.

3. Më 28 qershor 2017, paneli i Gjykatës Kushtetuese nxori Aktvendimin e vet mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara. Rrjedhimisht, Shtojca I dhe Shtojca II e Referimit të Rregullave të Rishikuara riklasifikohen publike.

**PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARJA**

**riklasifikon publike Shtojcën I dhe Shtojcën II** në “Referim i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese”, nr. KSC-CC-PR-2017-03, të datës 31 maj 2017.

/nënshkrim/

---

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova  
Kryetare

E mërkurë , 28 qershor 2017

Në Hagë, Holandë